

KQZ
U PROTOKOLLUA
NR. 259/ PROT
DATE 08 6 2016

KERKESE

ZJ. LEFTERI LLESHI

KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE

TIRANE

Zj.Kryetare,

Ne kuader te zbatimit te ligjit nr.138/2015 " Per garantimin e integritetit te personave qe zgjidhen emerohen ose ushtrojne funksione publike", brenda afateve te percaktuar ne te kam plotesuar formularet e vetedeklarimit dhe e kam dorezuar ne KQZ.

Une gjate plotesimit te formularit te vetedeklarimit, ne rubriken ku kerkohet informacion nese kam qene apo jo i denuar ndonjehere me pare, kam deklaruar se nuk kam qene i denuar.

Ne kete konkluzion kam arritur pasi kam lexuar ndryshimet kushtetuese te miratuar me ligjin 137/2015, " Per disa ndryshime dhe shitesa ne ligjin nr.8417, date 21.10.1998 " Kushtetuta e republikes se Shqiperise" te ndryshuar", si dhe te vete ligjin nr.138/2015 " Per garantimin e integritetit te personave qe zgjidhen, emerohen ose ushtrojne funksione publike" dhe konkretishte.

Ne ndryshimet kushtetuese qe eshte edhe baza mbi te cilen mbeshtetet dhe buron vete ligji, ne nenin 2 ne ndryshimet qe i ben nenit 45 te kushtetutes duke shtuar nje paragraph te trete thuhet se "... perjashtohen nga e drejta per tu zgjedhur shtetasit qe jane te denuar me burgim me vendim perfundimtar te forms se prere per kryerjen e nje krimi sipas rregullave te percaktuar me ligj te miratuar me tri te pestat e te gjitha anetarve te Kuvendit...". Pra ky ndryshim kushtetues ne asnje moment nuk bene fjale per rastet e denimit me nje gjobe apo denime te tjera alternative te denimit me burgim.

Edhe vete ligji nr.138/2015 ne nenin 5 te tij thote se "... personat e parashikuar nga nenet 2 dhe 3 te ketij ligji duhet te plotesojne e te nenshkruajne nje formular vetedeklarimi, me ane te te cilit te deklarojne mosekzistencen e shkaqeve per te kandiduar per te mos u zgjedhur ose emeruar...".

Perse e bera kete trajtim teorik te ndryshimeve kushtetuese dhe te vete ligjit nr.138/2015. Prpara me shume se 20 vjet dhe konkretisht me vendim nr.1397 date 22.12.1995 jam denuar per shpifje parashikuar nga neni 120/2 i K.Penal me 10 000 (dhjete mije) lek gjobe.

Kete denim gjate plotesimit te formularit te vetedeklarimit, nuk e kam pasqyruar. Lidhur me kete "pasaktesi" ne plotesimin e formularit te vetedeklarimit lidhet me disa aspekte profesionale dhe personale per te cilet po jap opinionin tim.

Se pari si ndryshimet kushtetuese te miratuara me ligjin 137/2015, " *Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.8417, date 21.10.1998 " Kushtetuta e republikes se Shqiperise " te ndryshuar*" dhe vete ligjin nr.138/2015 " *Per garantimin e integritetit te personave qe zgjidhen , emerohen ose ushtrojne funksione publike*" flasin qe ne fillim dhe ne fund, per persona qe kane rekorde kriminale te cilat kane sjelle me patjeter denime me burgime, dhe asnje dispozite nuk behet fjale per nje denim tjeter te nje lloji alternativ. Pra personi i cili privohet nga e drejta per tu zgjedhur apo emeruar ne funksione publike duhet me patjeter qe te jete i denuar me burgim dhe me tej qe te plotesoje kerkesat e nenin 2 te ligjit 138/2015.

Se dyti edhe ligji kerkon, qe mos shenimi i informacionit ne formularin e vetedeklarimit nga subjekti nese ka qene apo jo i denuar, e lidh ne menyre te pazgjidheshme me nenin 2 te ligjit 138/2015 dhe jo me cfaredo denimi. Mos tregimi i rrethanave te kerkuara ne nenin 2 te ligjit 138/2015 e bene personin konkret subjekt te largimit nga funksioni publik dhe te nenit 190 te K.Penal sikurse parashikohet ne nenet 5/3 dhe neni 10 i ligji 138/2015. Pra fryma e ligjit eshte e tille qe te vere perpara pergjegjesise te gjithë personat qe kane detyrimin te bejne vetedeklarimin, dhe ata te fshehin denimet penale me burgim, per vepra penale qe ligji i ndalon te marrin pergjegjesi publike. Ne rastin konkret denimi i dhene ndaj meje eshte dhene perpara 20 vjetesh, per nje veper qe rendomt deputetet kane akuzuar njeri tjeterin dhe jane denuar.

Ne lidhje me kete denim doja qe t'i referohesha edhe K Penal te Republikes se Shqiperise. Nga permbajta e nenit 69/a te Kodit Penal, une konsiderohem "*i padenuar*". Ne kete dispozite dhe qe eshte e vetmja e cvila jep definicionet e denimit dhe personit te pa , thuhet vec te tjerash se "*...quhen te padenuar : a) Ata qe jane denuar me burgim per nje kohe deri ne 6 muaj ose me cdo denim tjeter me te lehte dhe qe gjate 2 viteteve nga data e vuajtjes se denimit nuk ka kryer veper tjeter penale...*"

Pra vepra penale per te cilen une jam ndeshkuar eshte parashkuar gati 10 here. Njekohesisht ajo nuk eshte nga ato vepra qe penalizojne perfundimisht apo per periudhe kohe te gjata personat qe kerkojne te marrin pergjegjesi publike.

Do te kerkoja nga ana juaj qe gjate shqyrtimit te kesaj kerkese, te mbanit parasysh nenin 81/2 germa "d" dhe nenin 116 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, per faktin e perparësive qe ka zbatimi i Kodit Penal ne raport me ligjin 138/2015. Shkalla e hierarkise se zbatimit te ligjeve ne vendin tone, u jepe perparësi kodeve ne raport me te gjitha ligjet, dhe ne rastin konkret edhe perpara ligjit 138/2015.

Se dyti periudha qe u plotesua formulari i vetedeklarimit nga ana ime rastisi edhe me nje situate shendetesore tejet e renduar. Ne ate periudhe kam qene i shtruar ne spital ne Turqi dhe familjaret e mi ma kane sjelle formularin dhe aty e kame plotesuar per te bere deklarimin brenda afateve te percaktuara ne ligj. Mos deklarimi i ketij denimi duhet te konsiderohet edhe si nje gabim njerezor i diktuar nga gjendja shendetesore. Edhe sot qe po ju shkruaj kete kerkese une vazhdoj te jem me rregjim shtrati per shkak te gjendjes shendetesore.

Megjithate ne kuader te transparences qe cdo i zgjedhur duhet te mbaje ne raport me drejtesine, pavarsishte se kjo vendimarrje nuk influecon ne ushrimin e funksioneve te deputetit, kerkoj qe ky deklarim te konsiderohet si pjese integrale e formularit te vetedeklarimit per llogari te ligjit 138/2015.

Duke shpresuar ne mirekuptimin Tuaj, mbetem me shprese se kerkesa do te vlersohet sipas ligjit dhe situates konkrete shendetesore.

Tirane me dt.31.5.2016

KERKUESI
SPARTAK BRAHO

